



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 11.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Lumjetë Havolli Blakçori B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Punimi i bustit**”, me Nr. të Prok: 632-21-2228-5-3-6, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Lumjetë Havolli Blakçori B.I.**, e dt. 08.06.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i bustit**”, me Nr. të Prok: 632-21-2228-5-3-6, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 04.06.2021 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: **04.06.2021**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Lumjetë Havolli Blakçori B.I.**, me dt. 08.06.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Punimi i bustit**”, me Nr. të Prok: 632-21-2228-5-3-6,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 11.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Lidhur me pretendimet tuaja, Autoriteti Kontraktues, sqaron se: bazamenti i Bustit të shkollës është i punuar me kualitet jo të mirë, pllakat dhe puna është kryer dhe finalizuar (gjendja momentale v.j.) për një kohë të përkohshme, me iniciativën dhe punën e prindërve, të cilët kanë fëmijët e tyre në këtë shkollë! Si pasojë, pllakat kanë filluar të dëmtohen sepse cilësia e tyre është e dobët, konstatim ky edhe i eksperteve të kësaj lëmie! Andaj, këto pllaka domosdoshmërisht në një afat kohor duhet zhvendosen!

-Po ashtu, edhe Busti është vendosur përkohësisht nga Familjaret e Emin Duraku-t, si dhe Veteranet e LNÇ-së, derisa të punohet Busti i Ri, sipas kërkesës dhe përshkrimit në ofertën e bërë të njësisë kërkesës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës